



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E KULTURËS
KËSHILLI KOMBËTAR I TRASHËGIMISË KULTURORE MATERIALE

Nr. 790 Prot.

Tiranë, më datë 24.08.2020

VENDIM

Nr. 246, datë 29.07.2020

Në mbështetje të Ligjit Nr. 27, datë 17.05.2018 “Për Trashëgiminë Kulturore dhe Muzetë”, neni 38, pika 2, V.K.M Nr. 208, datë 10.04.2019 “Për Përbërjen, Mënyrën e funksionimit, Kompetencat dhe Shpërblimin e Anëtarëve të Këshillit Kombëtar të Trashëgimisë Kulturore Materiale”, pas shqyrtimit më parë të projektit në Këshillin Teknik, Këshilli Kombëtar i Trashëgimisë Kulturore Materiale, në mbledhjen e datës 29.07.2020,

VENDOSI:

1. Shtyrjen e vendimmarrjes për projektin “Rikonstruksion dhe rindërtim banese pas tërmetit të 26 Nëntorit 2019, në Lagjen 1, Rr. “Doktor Margariti”, zona arkeologjike Durrës”, kërkesë e familjes Myshketa me hartues person i licencuar në restaurim Ark. L. Shehaj;
- Respektimi i V.K.M.-së Nr.442, datë 03.06.2020 “Për Shpalljen e Zonës së re për Zhvillim, në Njësinë Administrative Durrës, Bashkia Durrës, dhe caktimin e Fondit Shqiptar të Zhvillimit si njësi zbatuese” dhe deri në detajimin e Planit të Menaxhimit të Integruar të Parkut Arkeologjik Durrës;
2. Ngarkohet Instituti Kombëtar i Regjistrimit të Trashëgimisë Kulturore për regjistrimin e këtij Vendimi;
3. Ngarkohet Sekretaria Teknike për njoftimin e këtij Vendimi;
4. Ndaj Vendimit mund të ushtrohet ankimi në gjykatën kompetente për shqyrtimin e mosmarrëveshjeve administrative. Ankimi nuk pezullon zbatimin e aktit administrativ.

Ky Vendim hyn në fuqi menjëherë.

SEKRETAR
Arta DOLLANI

KRYETAR

Elva MARGARITI

